



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
FAKULTETI I EDUKIMIT FIZIK DHE I SPORTIT

Prishtinë, Mars 2025


BULETINI
INFORMATIV

Janar-Mars 2025



STUDENTËT TANË, AMBASADORË TË FAKULTETIT TË EDUKIMIT FIZIK DHE TË SPORTIT NËPËR BOTË!

Studenti ynë, Eron Hoxha, përfaqësoi me dinjitet Fakultetin e Edukimit Fizik dhe të Sportit të Universitetit të Prishtinës në Universitetin e Karamanit, Turqi. Ai mbajti dy prezantime të rëndësishme para studentëve të nivelit Master dhe Bachelor: një analizë kritike mbi një hulumtim shkencor dhe një prezantim mbi përfitimet e programit Erasmus. Eroni theksoi mundësitë për studim dhe punë, përfshirjen në projekte ndërkombëtare, hulumtimet shkencore dhe diversitetin kulturor e sportiv. Puna dhe përkushtimi i tij janë një shembull i shkëlqyer i cilësisë akademike që synon Fakulteti ynë.



VIZITA E KRYETARIT TË KËSHILLIT DREJTUES TË UNIVERSITETIT TË PRISHTINËS NË FAKULTETIN E EDUKIMIT FIZIK DHE SPORTIT

Fakulteti i Edukimit Fizik dhe Sporteve mirëpriti Kryetarin e Këshillit Drejtues të Universitetit të Prishtinës, z. Altin Sahiti, në një vizitë zyrtare, ku u diskutua thellimi i bashkëpunimit dhe roli i fakultetit në sport dhe edukim. Z. Sahiti vlerësoi punën e menaxhmentit dhe inkurajoi avancimin e mbështetjes për studentët dhe stafin akademik. Një temë kyçe ishte angazhimi i FEFS në organizimin e Lojërave Mesdhetare 2030 në Prishtinë. Vizita konfirmoi mbështetjen e Këshillit Drejtues për fakultetin dhe rëndësinë e tij në zhvillimin akademik dhe sportiv.



STARTON KURSI I SKIJIMIT NË BREZOVICË – NJË EKSPERIENCË E JASHTËZAKONSHME!

Studentët e Fakultetit të Edukimit Fizik dhe Sportit kanë nisur me sukses kursin e skijimit në mrekullinë natyrore të Brezovicës!

Ky aktivitet unik përfaqëson jo vetëm thelbin e traditës sonë sportive, por edhe pasqyron përkushtimin e palodhur të stafit tonë profesional ndër vite, si dhe energjinë dhe entuziazmin e studentëve tanë të shkëlqyer.

Jemi krenarë që po formojmë gjenerata të reja liderësh në edukim fizik dhe sportiv, të cilët sfidojnë veten në pistat e skijimit dhe tejkalojnë kufijtë e ekselencës.





VIZITË E REKTORIT DHE PROREKTORËVE NË FAKULTETIN E EDUKIMIT FIZIK DHE SPORTIT

Fakulteti i Edukimit Fizik dhe Sportit pati kënaqësinë të mirëpresë Rektorin e Universitetit të Prishtinës, Prof. Dr. Arben Hajrullahu, si dhe prorektorët Prof. Assoc. Dr. Albana Oehaja Berisha, Prof. Assoc. Dr. Avni Hajdari dhe Prof. Dr. Naim Jerliu, në një vizitë të rëndësishme ku u diskutuan tema kyçe për të ardhmen e fakultetit dhe zhvillimin e mëtejshëm të Universitetit të Prishtinës.

Një nga temat kryesore të diskutimit ishte ndërtimi i objektit të ri të Fakultetit të Edukimit Fizik dhe Sportit, bazuar në nevojat dhe kërkesat programore të fakultetit, për të siguruar kushte më të mira për mësimdhënie, kërkime shkencore dhe zhvillimin e sportit universitar.

Gjithashtu, gjatë takimit u diskutuan edhe çështje të tjera të rëndësishme për përparimin e mëtejshëm të UP-së, përmes projekteve dhe bashkëpunimeve strategjike.

Falënderojmë Rektorin dhe Prorektorën/Prorektorët për vizitën dhe mbështetjen e tyre të vazhdueshme për zhvillimin e Fakultetit të Edukimit Fizik dhe Sportit!



FAKULTETI I EDUKIMIT FIZIK DHE SPORTIT (FEFS), NË BASHKËPUNIM ME QENDRËN PËR PËRSOSMËRI NË MËSIMDHËNIE (QPM), ORGANIZOI ME SUKSES TRAJNIMIN "METODAT INTERAKTIVE NË ARSIMIN E LARTË"

Ky trajnim u fokusua në praktikat më të mira dhe inovative në fushën e mësimdhënies, duke ofruar mundësi për zhvillim profesional dhe shkëmbim përvojash mes pjesëmarrësve.

Ligjërueset kryesore të këtij trajnimi ishin Prof. Asst. Blerta Mustafa, kordinatore e QPM-së, dhe Dr. Zinaide Gruda, trajnere në QPM, të cilat ndanë njohuritë dhe përvojën e tyre në teknikat bashkëkohore të mësimdhënies.

Pjesëmarrësit patën rastin të përfitojnë nga përvojat e profesionistëve të fushës dhe të diskutojnë ide për përmirësimin e procesit mësimor në arsimin e lartë.


Në përmbyllje të trajnimit, pjesëmarrësit u pajisën me certifikata, si një dëshmi e angazhimit dhe përkushtimit të tyre për avancimin e metodave mësimore.

Fakulteti i Edukimit Fizik dhe Sportit shpreh falënderime të veçanta për Prof. Asst. Blerta Mustafa dhe Dr. Zinaide Gruda për kontributin e tyre të çmuar në këtë aktivitet.



ANGAZHIM, MBËSHTETJE DHE SHËRBIM

Administrata e Fakultetit të Edukimit Fizik dhe të Sportit është gjithmonë e përkushtuar për të mbështetur suksesin e studentëve në rrafshin akademik dhe profesional. Ne jemi këtu për t'ju ndihmuar në çdo hap të rrugëtimit tuaj universitar, duke ofruar asistencë në çështjet administrative për të ngritur cilësinë e studentëve.



ISH-STUDENTËT E FAKULTETIT TË EDUKIMIT FIZIK DHE SPORTIT SHKËLQEJNË NË DUBAI GAMES!

Ekipi "Illyrians", i përbërë nga ish-studentët tanë që sot shërbejnë si trajnerë fizikë për Gardën Presidenciale në Emiratet e Bashkuara Arabe, ka arritur një sukses në Dubai Games, garat më prestigjioze në Emirate!

Në kualifikimet e mbajtura mes 58 ekipeve, "Illyrians" siguruan vendin e 10-të, duke u bërë një nga 27 ekipet që kaluan në gjysmëfinale, duke lënë pas edhe ekipin e Serbisë. Tani ata përgatiten për sfidën e radhës më 22 dhe 23 shkurt, ku vetëm 4 ekipe do të sigurojnë biletën për finalen!

Fakulteti i Edukimit Fizik dhe Sportit është krenar për përfaqësimin e jashtëzakonshëm të ish-studentëve të tij:

Rrustem Ahmetxhekaj, Nar Statovci, Labinot Zeneli, Riard Statovci, Rinor Behluli, Dior Sherifi dhe Kushtrim Hetemi.

Ju urojmë suksese në sfidën e radhës – krenaria juaj është edhe krenaria jonë! Forca Illyrians!



KRENAR PËR STUDENTËT TANË!

Në kuadër të ceremonisë së 55-vjetorit të themelimit të Universitetit të Prishtinës, studentet tona të dalluara, Benita dhe Bleona Juniku, janë shpërblyer me mirënjohje nga Rektori për suksesin dhe kontributin e tyre akademik.

Kjo arritje është dëshmi e përkushtimit dhe punës së palodhur të studentëve tanë, të cilët vazhdojnë të jenë shembull i ekselencës në Fakultetin e Edukimit Fizik dhe të Sportit.

Urime Benita dhe Bleona!

Jemi krenarë për ju dhe për të gjithë studentët tanë që kontribuojnë në ngritjen e nivelit akademik dhe profesional të sportit në Kosovë.




NJË BASHKËPUNIM I SUKSESSHËM MËS FAKULTETIT TË EDUKIMIT FIZIK DHE SPORTIT (FEFS) DHE QENDRËS SË STUDENTËVE (QS) NË PRISHTINË.

Falë kësaj marrëveshjeje të vlefshme dhe angazhimit të përbashkët, kemi krijuar një ambient modern dhe të pajisur me standarde të larta për fitnesin, i cili do t'u shërbejë studentëve tanë në zhvillimin e tyre akademik dhe fizik.

Në këtë kontekst, dëshirojmë të shprehim mirënjohjen tonë të veçantë për drejtorin e Qendrës së Studentëve, z. Ekrem Rudari – një ish-student i fakultetit tonë – për përkushtimin dhe mbështetjen e tij të vazhdueshme. Falë këtij bashkëpunimi, studentët tanë tani kanë në dispozicion një hapësirë bashkëkohore dhe profesionale për zhvillimin e lëndës së fitnesit dhe aktiviteteve të tjera sportive.

Faleminderit të gjithë atyre që kontribuan në realizimin e këtij projekti të rëndësishëm!





FEFS KA ADAPTUAR NJË KLASË MODERNE PËR MËSIMDHËNIE

Si rezultat i marrëveshjes me Qendrën e Studentëve për zhvendosjen e Fitnesit në Sallën 1 Tetori , FEFS ka adaptuar një klasë moderne për mësimdhënie, duke rritur kështu cilësinë dhe efikasitetin e procesit tonë akademik.



NË FAKULTETIN E EDUKIMIT FIZIK DHE SPORTIT ËSHTË ORGANIZUAR GJIMNASTRADA E KOSOVËS 2025 NGA FEDERATA E GJIMNASTIKËS E KOSOVËS.

Në këtë aktivitet morën pjesë 186 fëmijë, 8 klube gjimnastikore me gjithsej 13 performanca të shkëlqyeshme.

Fakulteti i Edukimit Fizik dhe i Sportit vazhdon të jetë partner i rëndësishëm i zhvillimit të sportit, bashkëpunimit me Federatat Sportive, dhe promovimit të shëndetit edhe tek gjeneratat e reja në vend.



TAKIMI I PARË PËR ORGANIZIMIN E KONFERENCËS SHKENCORE TË FEFS-UP!

U mbajt takimi i parë për organizimin e Konferencës Shkencore të Fakultetit të Edukimit Fizik dhe Sportit, ku u diskutuan çështje kyçe si koordinimi i aktiviteteve, themelimi i Bordit Shkencor dhe aspektet organizative të konferencës. Ky takim shënoi hapin e parë drejt një eventi cilësor që synon të promovojë kërkimin shkencor dhe bashkëpunimin akademik.

Falenderojmë të gjithë pjesëmarrësit, menaxhmentin e fakultetit, profesorët dhe studentët për angazhimin e tyre!

Qëndroni të informuar për zhvillimet e radhës!



VIJON KURSI I GJUHËS ANGLEZE NË FAKULTETIN E EDUKIMIT FIZIK DHE SPORTI

Fakulteti i Edukimit Fizik dhe Sporteve ka nisur kursin e gjuhës angleze për stafin akademik, personelin administrativ, studentët dhe individë të tjerë të interesuar që punojnë në FEFS. Kursi gjashtëmuor ka si qëllim kryesor përmirësimin e aftësive të folurit dhe të shkruarit në gjuhën angleze, duke e bërë atë më të lehtë dhe më efektiv për përdorim në kontekste të ndryshme.

Ky kurs është i disponueshëm në nivelet B1, B2, C1, dhe C2 dhe është i strukturuar në tre module, secila prej dy muajsh, për t'i mundësuar pjesëmarrësve të përparojnë gradualisht.

Secili modul përfshin aktivitete të ndryshme praktike dhe ushtrime që synojnë zhvillimin e të folurit, leximit, shkrimit duke synuar përmirësimin e shkathtësive të tyre në situata reale të komunikimit, klike modulën këtu.



ANALIZË E PROGRAMIT MASTER - EDUKIM FIZIK DHE SPORT ME STUDENTET E FEFS

Është mbajtur takimi me studentët e FEFS me qëllim analizimin e programit Master në Edukim Fizik dhe Sport, në mënyrë që të bëhen plotësimet dhe ndryshimet e mundshme bazuar në kërkesat e tyre.

Në takim ishin të pranishëm, përveç menaxhmentit të FEFS, edhe anëtarët e këshillit të studentëve, si dhe studentë nga programet Bachelor dhe Master.

Të gjitha opinionet e studentëve do të merren parasysh në ridizajnimin e programit aktual të Masterit në Edukim Fizik dhe Sport.



MBAHET KONFERENCA E PARË SPORTIVE NË FAKULTETIN E EDUKIMIT FIZIK DHE TË SPORTIT NË UNIVERSITETIN E PRISHTINËS

Me shumë sukses është mbajtur Konferenca e Parë Sportive në Fakultetin e Edukimit Fizik dhe të Sportit në Universitetin e Prishtinës. Kjo ngjarje shënon një hap të rëndësishëm drejt promovimit të dialogut ndër-institucional, shkëmbimit të përvojave dhe thellimit të bashkëpunimeve në fushën e sportit.

Faleminderit nga zemra të gjithë të pranishmëve për pjesëmarrjen dhe mbështetjen e tyre, si dhe panelistëve të nderuar, të cilët me fjalët, përvojën dhe vizionin e tyre pasuruan këtë konferencë:

1. Z. Përparim Rama, Kryetar i Komunës së Prishtinës
2. Z. Ismet Krasniqi, Kryetar i Komitetit Olimpik të Kosovës
3. Z. Avni Ponari, Kryetar i Federatës së Basketbollit të Shqipërisë
4. Z. Arben Fetahu, Kryetar i Federatës së Basketbollit të Kosovës
5. Z. Blerand Stavileci, Kryetar i Klubit të Basketbollit
6. Z. Florian Miftari, Dekan i Fakultetit të Edukimit Fizik dhe të Sportit

7. Z. Korab Sejdiu, Avokat i mirënjohur dhe kontribuues i vazhdueshëm në çështje të sportit dhe shoqërisë
Kjo konferencë nuk do të ishte e mundur pa përkushtimin e stafit akademik, studentëve dhe partnerëve të shumtë që besojnë në fuqinë e sportit si motor zhvillimi, bashkimi dhe edukimi.

Në fund, falënderojmë të gjithë të pranishmit për pjesëmarrjen, mbështetjen dhe energjinë pozitive që sollën në këtë ngjarje të veçantë. Konferenca e Parë Sportive ishte vetëm fillimi – së bashku do të vazhdojmë të promovojmë sportin, edukimin dhe bashkëpunimin rajonal në çdo hap.






MENAXHMENTI MBAN TAKIM ME KËSHILLIN E STUDENTËVE DHE ADMINISTRATORË TË LABORATORIT TË SHKENCAVE SPORTIVE

Në Fakultetin e Edukimit Fizik dhe të Sportit është mbajtur një takim i rëndësishëm ndërmjet menaxhmentit të fakultetit, Këshillit të Studentëve dhe administratorëve të laboratorit të Shkencave Sportive.

Gjatë këtij takimi janë diskutuar një sërë çështjesh me rëndësi, të cilat lidhen me adresimin e kërkesave dhe nevojave të studentëve në raport me menaxhmentin dhe stafin akademik e administrativ të fakultetit.

Theksojmë se studentët tanë përfaqësojnë shtyllën kryesore jo vetëm të fakultetit, por edhe të shoqërisë në tërësi. Angazhimi i tyre aktiv dhe bashkëpunimi i ndërsjellë me strukturat udhëheqëse të fakultetit mbetet thelbësor për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë akademike dhe profesionale.

Takime të tilla janë dëshmi e vullnetit për të ndërtuar një ambient universitar gjithëpërfshirës, ku zëri i studentit dëgjohet dhe merret seriozisht.



NJË HAP I RI, NJË EPOKË E RE PËR MBËSHTETJEN E STUDENTËVE TANË!

Në ambientet e Fakultetit të Edukimit Fizik dhe Sportit, u ndanë katër bursa studentore nga Federata e Futbollit e Kosovës – një akt domethënës që shënon fillimin e një tradite të re bashkëpunimi ndërmjet institucionit tonë dhe federatave sportive.

Kjo mbështetje konkrete për studentët më të dalluar jo vetëm që vlerëson përkushtimin e tyre akademik dhe praktik, por edhe forcon lidhjen ndërmjet arsimit dhe sportit.

Faleminderit Federatës së Futbollit të Kosovës dhe kryetarit z. Agim Ademi për këtë kontribut të çmuar në edukimin dhe zhvillimin e gjeneratave të ardhshme sportive!


Ky është vetëm fillimi i një bashkëpunimi të frytshëm për të ndërtuar një të ardhme edhe më të ndritur për sportin dhe të rinjtë tanë!





Për më shumë informata, ju lutem kontaktoni :

 fefs@uni-pr.edu

 +383 38 243 747



Copyright (C) 2025 Fakulteti i Edukimit Fizik dhe i Sportit
Universiteti i Prishtinës